

QEVERIA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
Departamenti i rinisë



OJQ "MILENIUMI I RI"
Prishtinë

12 Gushti DITA NDËRKOMBËTARE E RINISË Prishtinë

Mbështetur nga:



KOMANDA E PRISHTINËS



12 Gushti

—

Dita Ndërkombëtare e Rinisë

(Raport për aktivitetet e Ditës së Rinisë – 12 Gusht 2009 Prishtinë)

Prishtinë, Gusht 2009

Ky është raport përshkrues për projektin e Ditës Ndërkombëtare të Rinisë.

Projekti është realizuar nga OJQ Mileniumi i Ri dhe është financuar nga Departamenti i Rinisë (DiR), Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve (MKRS/DiR).

Projekti është udhëhequr nga :

Nehat Bllacaku dhe

Koordinatorja e Aktiviteteve

Albulena Hyseni

Raportin e përgatitën : Nehat Bllacaku dhe Teuta Rexhepi

Falënderim :

Në emër të OJQ-së Mileniumi i Ri në falënderojmë MKRS/DiR për financimin dhe mbështetjen gjatë të gjitha fazave. Në veçanti falënderojmë z. Fatmir Hoxha Drejtor i DiR, z. Kreshnik Xharra nga DiR dhe Alban Berisha po nga DiR.

Gjejmë rastin të falënderojmë dhe : znj. Mevlude Zejnullahu dhe znj. Arbenita Rrmoku që mbështetën moralisht dhe ofruan këshillat e tyre.

Në fund dëshirojmë të falënderojmë edhe : Fabrikën “Bonus – Bonita” në Lipjan, Firmën “Algida”, Fabrikën e Ujit “Ujë Rugove” dhe Fakultetin e Arteve të UP-së.

Hyrje

Dita Ndërkombëtare e Rinisë – 12 Gushti 2009, edhe këtë vit u shënu nën patronatin e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Departamentit të Rinisë. Por, për dallim prej viteve tjera këtë vit organizimi i është besuar një OJQ-je, në këtë rast OJQ-së Mileniumi i Ri. Në fakt roli ynë ka qenë më shumë koordinues. Aktivitetet kryesore bashkë me agjendën konkrete të kësaj dite, janë përgatitur në bashkëpunim të ngushtë me drejtuesit e DiR-it. Bashkëpunimi ka qenë i nivelit të lartë dhe duhet thënë vendimtar. DiR ka financuar krejtësisht aktivitetet e kësaj dite.

Rinia në Kosovë ballafaqohet me shumë probleme. Natyrisht që problemi më shqetësues është papunësia. Si pasoj e papunësisë dëshirat dhe ëndrrat e mijëra të rinjve nga Kosova mbesin vetëm si të tilla. Institucionet e Kosovës, veçanërisht DiR, autoritetet lokale dhe qindra OJQ nga pjesë të ndryshme të vendit kanë zhvilluar dhe zhvillojnë aktivitete, për dhe me të rinjtë. Qendrat rinore nga mbarë Kosova shërbejnë si një fole e rëndësishme dhe vend-takim për qindra të rinj, njëherit mundësi e mirë për tu takuar, njohur dhe shkëmbyer ide dhe përvoja. Si pasoj e kushteve të rënda sociale të familjeve të tyre, të rinjtë nuk kanë mundësi të ndjekin shkollimin e rregullt, veçanërisht studimet universitare paraqesin problem, pasi jo të gjithë e kanë afër dhe për të udhëtuar dhe ndjekur studimet duhet mjaft investime, që në fakt për shumë familje janë vetëm dëshira.

E ardhmja e rinisë është në Evropë sikur edhe e shtetit tonë të ri, por të gjithë ne duhet të jemi të përkushtuar, pavarësisht prej kushteve, duhet të punojmë me shtresën e re, në mënyrë që ata të arsimohen dhe përgatiten për të shërbyer vetes, familjes dhe vendit. Kosova meqë është vend i vogël dhe jo i zhvilluar, ka potencialin shumë të rëndësishëm, ky potencial janë RINIA.

Stafi

Mesazh për Ditën Ndërkombëtare të Rinisë nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së !

Tema e këtij viti për Ditën Ndërkombëtare të Rinisë është: “*Qëndrueshmëria: Sfida jonë. E ardhmja jonë*”. Me këtë rast Sekretari i përgjithshëm i OKB-se Ban Ki Moon dha këtë mesazh për rininë botërore. *“Është një thirrje mbarëbotërore për veprim drejtuar të gjithë të vajzat dhe djemtë e rinj. Bota jonë ballafaqohet me kriza të shumta e të ndërlydhura, me ndikime të ndryshme dhe të thella, që bien në mënyrë jo proporcionale mbi shpatullat e të rinjve. Në vitin 2007, për shembull, rinia përbënte 25 për qind të popullsisë në moshë pune në të gjithë globin dhe llogaritej të përbënte 40% të numrit të të papunësuarve. Rënia e madhe ekonomike botërore do të thotë që në kohë të afërta, papunësia mes të rinjve do të vazhdojë të rritet. Përqindjet e papunësisë flasin vetëm për një anë të problemit, në këtë rast për shumicën dërrmuese të të rinjve që jetojnë në vendet në zhvillim. Por ta tashmë punësimi informal, i pasiguruar dhe me paga të ulëta është shndërruar në një normë, dhe jo në përjashtim. Ndryshimi i klimës, ndërkohë, vazhdon të rrezikojë ekonominë dhe të kërcënojë me trazira të mëdha, duke i ngarkuar të rinj me një “borxh ekologjik” të padrejtë. Kjo është një barrë shumë e rëndë. Por, në të njëjtën kohë, unë jam inkurajuar nga kontributi që të rinjtë kanë dhënë për debatin mbi lehtësimin dhe përshtatjen me ndryshimin e klimës. Pikëpamjet dhe propozimet e tyre mund të ndihmojnë për të arritur momentin e nevojshëm për “zgjidhur këtë çështje” në Kopenhagë gjatë vitit në vijim. Me të vërtetë, të rinjtë e kanë dëshmuar veten të jenë partnerë kyç në zhvillimin e qëndrueshëm. Ata janë përfshirë në forume ndërkombëtare, të tilla si Komisioni për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe kanë ndihmuar qeveritë dhe komunitetet e tyre për të hartuar strategji për zvogëlimin e varfërisë, skema të ndryshme sipërmarrjeje si dhe mjaft iniciativa dhe politika të thera. Të rinjtë shpesh udhëhiqen nga shembuj: praktikimi i një mënyre jetese të shëndetshme dhe të gjelbër, ose promovimi i përdorimit inovativ i teknologjive të reja, të tilla si pajisjet mobile apo rrjetet sociale on-line. Të rinjtë meritojnë përkushtimin tonë të plotë — për një qasje të plotë në edukim, kujdes shëndetësor të duhur, për mundësi punësimi, shërbime financiare dhe pjesëmarrje të plotë në jetën publike. Në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, ke të përsërisim dhe njëherë zotimin tonë për të mbështetur të rinjtë në zhvillimin e tyre. Qëndrueshmëria është shtegu më premtues drejt së ardhmes dhe të rinjtë mund të na udhëheqin në këtë rrugë.*



I juaji :
Ban Ki Moon

Agjenda kryesore

Aktivitetet kryesore më 12 Gusht, janë mbajtur në Sheshin “Nëna Terezë” dhe kanë qenë:

1. Parada rinore;
2. Dhurimi Vullnetar i Gjakut;
3. Panairi i Rinisë;
4. Ekspozita me fotografi dhe
5. Pikturimi i hapur



AKTIVITETI	VENDI DHE KOHA E REALIZIMIT	PRODUKTET QË PREZANTOHEN/SHFAQEN OSE KRIJOHEN	PJESËMARRËSIT
PARAKALIM (Paradë Rinore)	Sheshi “Nëna Terezë” Prishtinë 09 00 : 09 30	Gjatë parakalimit do të përdorën fanella, moto, poster dhe shpërndahen fletushka	Të rinjtë e shkollave fillore dhe të mesme, organizata rinore, të interesuar tjerë
PUNËTORI PIKTURIMI DHE VIZATIMI	Sheshi “Nëna Terezë” (Para Teatrit Kombëtar) 10 00 : 12 00	Piktura, fotografi, prezantime të punimeve të ndryshme për vizitorët në shesh	Të rinjtë e ndryshëm që merren me piktura, apo fotografi, ose ata që dëshirojnë të provojnë talentin e tyre
TË RINJËT DHUROJNË GJAKË	Sheshi “Nëna Terezë” (Para Teatrit Kombëtar) 10 00 : 13 00	Të rinjtë do të dhurojnë gjak për Institutin Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut, në ndihmë nevojtarëve	Të rinjtë e moshave të ndryshme, sportistët, artistët dhe të interesuarit tjerë
TURNIR TENISI	Stadioni i Klubit të Tenisit “PRISHTINA” Shkolla Fillore “Ismail Qemajli” 13 00 : 15 00	Turnir tenisi, në mes të grupeve të ndryshme rinore, sportistëve, aktorëve dhe OJQ-ve	Të rinjtë, sportistë, aktorë, aktivistë të OJQ-ve dhe të interesuar të tjerë
EKSPOZITA ME FOTOGRAFI DHE PANAIRI I ORGANIZATAVE RINORE DHE OJQ-VE TJERA	Pallati i Rinisë, Salla e Kuqe 14 00 : 16 00	Fotografi nga ambiente të ndryshme të kryeqytetit, fotografi të ndryshme nga të rinjtë. Panair në të cilin organizatat e ndryshme rinore dhe OJQ-të që merren me rininë, prezantojnë punën e tyre, botimet, aktivitetet dhe materialet e ndryshme	Të rinjtë nga shkollat e ndryshme, fotograf, organizata rinore, OJQ tjera që merren me rininë dhe të interesuar tjerë për të përcjell ekspozitën dhe panairin e OJQ-ve rinore

Parada e Rinisë

Ky aktivitet ka filluar me vonesë për shkak të të reshurave të mëdha që kanë rënë gjatë gjithë natës. Megjithatë një numër aktivistësh të organizatave dhe të ri një janë bashkuar në këtë aktivitet.

Dhurimi vullnetar i gjakut

Ky aktivitet është mbajtur nën strehën e Teatrit Kombëtar nga zyrtar të Entit të Transfuzionit të Gjakut. Të parët që dhuruan gjak ishin zyrtarët e DiR dhe ministrisë si: z. Salih Morina Sekretar Permanent i MKRS, Fatmir Hoxha Drejtor i DiR, Kreshnik Xharra zyrtar i DiR, Ilir Hoxha drejtues i Projektit të bankës Botërore në kuadër të DiR dhe të

tjerë. Aksionit për dhurimin e gjaku iu bashkuan edhe shumë të rinj, kalimtar dhe të interesuar të tjerë.

Panairi i Rinisë

Panairi u mbajt para Teatrit Kombëtar, në të u prezantuan botime të ndryshme, piktura, fotografi, pra kryesisht vepra për të rinjtë, projekte të realizuara, këshilla dhe gjithçka që në Kosovë realizohet për të rinjtë. Në panair u prezantuan: DiR me vullnetarët e vet, Qendrat Rinore nga Prizreni dhe Mitrovica, Qendrat Humane të financuara nga Banka Botërore dhe DiR, UNDP dhe agjencitë tjera të OKB-së në Kosovë, Jeta në Kosovë, Rrjeti i Grave të Kosovës, Mileniumi i Ri dhe të tjera. Numri i vizitorëve ishte i madh, me dhjetëra të rinj nuk hezituan për të marr këshilla dhe informata për aktivitetet e qendrave rinore dhe organizatave të tjera. Por interesim kishte edhe për të mësuar më tepër për mbrojtjen nga HIV/AIDS për çka me shumë kënaqësi ju shpjegonin përfaqësuesit e qendrave rinore dhe projekteve të ngjashme që mbështeten nga DiR, Banka Botërore dhe agjencitë e kombeve të bashkuara në Kosovë.



Ekspozita me fotografi

Për më shumë se një muaj stafi i OJQ-së Mileniumi i Ri dhe shumë aktivistë të organizatave rinore, kanë punuar në përgatitjen e ekspozitës me fotografi. Më shumë se 50 fotografi nga aktivitetet e rinisë janë ekspozuar në shkallët e Teatrit Kombëtar. Interesimi i vizitorëve ishte i madh, përderisa fotografitë pasqyrojnë aktivitete të shumta të organizuara nga DiR dhe organizatat e rinisë për vite me radhë. Ekspozita është vendosur me qëllim në shkallët e teatrit, për të pasuruar kulturën dhe motivin e rinisë për atë.



Pikturimi i hapur

Kavaletat e siguruara nga Fakulteti i Arteve shërbyen për të zhvilluar një pikturim të hapur, para Teatrit Kombëtar. Fëmijë të moshave të ndryshme pikturoar të ardhmen që ata e mendojnë. Të gjithë të veshur me bluza për nder të kësaj dite dukeshin uniformë dhe

mjaft të ngazëlyer gjatë pikturimit. Ishin 8 piktura të mëdha që janë zhvilluar në këtë ditë nga fëmijët e kryeqytetit. Pikturimi i hapur është një formë shumë e përhapur në qytete të mëdha, prandaj ishte një interesim i madh i qytetarëve, fëmijëve dhe medieve me këtë rast.

Aktivitetet tjera

Në ditën ndërkombëtare të rinisë, janë mbajtur edhe shumë aktivitete të tjera në shumë qytete tjera. Aktivitetet dhe debate janë mbajtur në Mitrovicë, debati i përbashkët, në Gjiilan hapja e qendrës “Dëgjo Rininë”, në Prishtinë është promovuar një analizë për pikëpamjet e rinisë, në Bogaj të Pejës ka filluar Kampi Multi-etnik, në Prilluzhë është mbajtur aktivitete sportive dhe kulturore.

Mediet

Mediet janë dritare përmes së cilës ne shohim gjithçka, sikur edhe na shohin dhe promovojnë të tjerët. Gjatë gjithë periudhës së përgatitjeve, organizimit dhe ditës së rinisë mediet kanë qenë pjesë e pandashme e aktiviteteve. Gjatë fazës së përgatitjeve janë bërë disa shkrime nga mediet si “Koha Ditore” për ditën e rinisë dhe është mbajtur një intervistë e Drejtorit të DiR-it z. Fatmir Hoxha dhe z.Nehat Bllacaku në TV 21. Në këtë emision janë paraqitur jo vetëm planet për 12 gushtin por edhe sfidat e rinisë dhe preokupimet e përgjithshme, sikur edhe planet e DiR dhe organizatave rinore për të ardhmen e rinisë. Ndërsa në ditën e rinisë 12 Gusht, kanë marrë pjesë pothuajse të gjitha mediet: RTK, KTV, TV 21, Klan Kosova, Rrokum, Koha Ditore, Lajm, Zëri, Epoka e Re, Info Press etj.

